




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-3686/13</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>01.11.2013</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.10.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-2414/13, për z. Agim Morina. – Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike në Komunën e Mamushës, për shkak të mungesës së provave për Konflikt Interesi, sepse Zyrtari i lartë nuk ushtron më funksion publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, për Zyrtarin e lartë, z. Agim Morina, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike në Komunën e Mamushës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Morina është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 28.08.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Morina, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë pas dërgimit të shkresës nga Komuna e Mamushës me nr. DPKI-03-3231/13 konstatojmë se zyrtari i lartë z. Agim Morina është shkarkuar nga detyra dhe nuk ushtron më funksionin e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike në Komunën e Mamushës dhe sipas ligjit në fuqi, kjo gjendje dëshmon se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

